

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



**Raport mbi realizimin e
premtimeve elektorale të
z. Pëllumb Binaj, Kryetari i
Bashkisë Selenicë**

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorale” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Pëllumb Binaj, Kryetari i Bashkisë Selenicë (Qershor 2019)

1. Do të ndryshojmë rrënjësisht situatën në Bashkinë e Selenicës dhe do të bëjmë çfarë është e mundur për ta kthyer atë në një model suksesi, pavarësisht shtrirjes së madhe dhe sfidave të panumërta që ajo paraqet;
2. Investime në infrastrukturën arsimore;
3. Investime në infrastrukturën shëndetësore;
4. Do të sjellim ujën e pijshëm në çdo fshat;
5. Krijimi i kushteve të duhura për biznesin e vogël, për të rritur mirëqënien në çdo familje;
6. Do të ndërtojmë më shumë rrugë.

Burimi 1: <https://www.newsbomb.al/gjikhuri-nga-selenica-ps-partia-qe-mban-premtimet-po-bejme-realitet-rrugen-e-lumit-te-vlores-169688>

Burimi 2: <http://ata.gov.al/2019/06/28/binaj-do-te-jemi-krah-per-krah-duke-folur-me-pak-dhe-duke-punuar-me-shume/>

Premtimet e arritura

1. Ndërtimi i Ujësjellësit të ri të Kotës, i cili do të garantojë 24 orë ujë me cilësi për banorët.
2. Ndërtimi i urës që lidh Trebloven me Selenicën. Një investim i Bashkisë Selenicë i cili ju mundëson banorëve lëvizje më të lirë.
3. Pastrimi i rrugëve dhe rrugicave në Njësinë Administrative Kotë.
4. Asfaltimi i rrugës “Llambi Bombaj” në Selenicë pranë Bashkisë dhe Spitalit.
5. Rehabilitimi i rrugës së dytë në fushën e Armenit me një gjatësi prej 2 km e quajtur “Ruga e Pemëve”. Kjo rrugë i vjen në ndihmë 150 fermerëve me 250 ha tokë.
6. Pastrimi i kanalit vaditës Drashovicë – Armen me gjatësi 11 km, që ju vjen në ndihmë fermerëve të fshatrave Armen, Picar, Lubonjë, Penokovë, Peshkëpi dhe Drashovicë.
7. Pastrimi i kanaleve vaditëse në Shkozë, Mesaplik dhe Brataj.
8. Pastrimi i Përroit të Otimës në Selenicë, në mbrojtje të banesave dhe tokave për gjatë gjatësisë së tij.
9. Pastrimi i kanaleve kulluese në Gumenicë dhe Mavrovë.
10. Rehabilitimi i fushës së sportit në Selenicë. Fusha tashmë është e rrethuar, me shkallë dhe porta të reja brenda standarteve të kërkuara nga FSHF.
11. Përfundoi linja e re e ujrave të zeza në Vllahinë e cila lidh pallatet me linjën kryesore.
12. Rehabilitimi i rrugës së amortizuar dhe hapja e kanaleve anësore në Velcë, Ramicë, Njësia Administrative Brataj.
13. Pastrimi dhe rehabilitimi i kanaleve kulluese të Armenit.
14. Rikonstrukcioni i rrugës së varrezave të fshatit Penkovë, Njësia Administrative Vllahinë.
15. Izolimi i burimit të Vrizit në fshatin Gjorm, i cili furnizon pjesën më të madhe të fshatit. Tashmë ujrat do të jenë të mbrojtura nga ndotja dhe disiplinuar për t’u mbledhur në depo.

16. Rikonstrukcioni i urës në fshatin Karbunar, e cila kishte dalë jashtë funksionit dhe ishte problem për lidhjen me fshatrat Kocul dhe Pocem. Njëkohësisht janë vendosur dhe tombinot në kanalet anësore pasi ujrën e shiut shkaktonte dëme.
17. Pastrimi i përroit në Armen, në Lagjen e Repartit (Otima).
18. Ndërtimi i argjinaturës së re dhe 8 penelave mbrojtës në Vjosë, për të frenuar përmytjet e tokave bujqësore në Selenicë.
19. Ndërhijrje në kanalin e bllokuar dhe hapjen e rrugës së fshatit Picar, Njësia Administrative Armen.
20. Pastrimi i Përroit Otima nga fillimi deri në grykëderdhjen e tij në Vjosë.

Premtimet e arritura pjesërisht (në proces)

1. Janë realizuar 75% e punimeve për Kantierin e Ujit në Selenicë, i cili do të garantojë 24 orë ujë të pijshëm e me cilësi për 7 660 banorë të Selenicës dhe fshatrave Kotë dhe Armen. Investimi do të përmyllet në muajt e parë të vitit 2021.
2. Po zhvillohen punimet për linjën e Ujësjetlësit Selenicë dhe Kotë, për të vazhduar më tej me Ujësjetlësin e Armenit.
3. Vijnë puna në Armen, ku po rikonstruktohet rruga bujqësore në shërbim të fermerëve dhe po pastrohen kanalet e dyta dhe të treta kulluese.
4. Vazhdon puna për rehabilitimin e kanaleve vaditëse në Harvalane, Hasomatin etj
5. Vazhdon puna për vënien në funksion të një vepre të madhe vaditëse në Bashkinë Selenicë, Kanalin e Dushkarakut.
6. Vazhdojnë punimet në Lotin II, Gjorm-Brataj-Ura e Laskos.
7. Vazhdojnë punimet në qytetin e Selenicës për hapjen e kanalit që përshkon lagjen Tubo dhe përfundon në drejtim të lumit Vjosë. Pas shumë vitesh ky investim do i japë zgjidhje përmytjeve të kësaj lagjeje, gjithashtu edhe tokave bujqësore.
8. Vazhdon puna në Bashkinë Selenicë për pastrimin e kanalit kryesor brenda qytetit Selenicë. Puna ka filluar me gërmime dhe transport inertesh në hijrje të qytetit të Selenicës dhe do të vazhdojë deri në lagjen Partizani nga ku fillon ky kanal.
9. Vazhdon puna në Bashkinë Selenicë për pastrimin e mbeturinave, një nga shqetësimet më të mëdha të konstatuara gjatë fushatës.

Burimi – Bashkia Selenicë Faqja Zyrtare - <https://www.facebook.com/Bashkia-Selenic%C3%AB-Faqja-Zyrtare-1658735837711272/>

Premtime të porealizuara

1. Investime në infrastrukturën arsimore;
2. Investime në infrastrukturën shëndetësore;
3. Krijimi i kushteve të duhura për biznesin e vogël, për të rritur mirëqënien në çdo familje;